

**Data 13.04.2023
Ora 15:32**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y. Merkaj, D. Alimemeti**
- **OJQ: KRIIK ODIHR**

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Jemi pak me vonesë për shkak të organizimit të mbledhjes mbas një seance të gjatë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në mbledhje janë të pranishëm 5 anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it. Në mbledhjen e sotme kemi dy

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

projektvendime për të shqyrtuar: i pari “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” dhe i dyti “Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN)”. Të dyja aktet janë iniciativa të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe pa dyshim që është Sekretari i Përgjithshëm që do të na i prezantojë, por ndërkohë para se të fillojmë me shqyrtimin e projektakteve, do të pyesja kolegët nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Po, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Po, kam çështje për të diskutuar jashtë rendit të ditës.

Znj. I. Nano: Në rregull, sapo të mbarojmë shqyrtimin e çështjeve të rendit të ditës, zonja Vukaj do të marrë fjalën. Kolegët e tjerë kanë çështje jashtë rendit të ditës? Jo. Fillojmë me projektvendimin e parë “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Zoti Sekretar i Përgjithshëm, ju lutem, një përmbledhje të shkurtër.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Neni 20, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator, i cili shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi. Referuar nenit 22 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ka kompetencë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit. Referuar kësaj pike të Kodit Zgjedhor, nenit 22, e cila parashikon kompetencën për të përdorur dhe vendosur përdorimin në zgjedhje të pajisjeve

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

elektronike, kemi përgatitur projektvendimin e mësipërm, ku është parashikuar që projekti pilot të shtrihet në tri bashki: Vorë, që ka qenë më parë, në Kamëz dhe në Elbasan. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, i paraqet Komisionit Rregullator projektvendimin e mësipërm. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj! Sikurse edhe ju e theksuat, është kompetencë e Komisionit Rregullator që në çdo zgjedhje të miratojë, së pari, përdorimin e pajisjeve të caktuara, qoftë të pajisjes elektronike të identifikimit, qoftë të kamerave në qendrën e votimit apo në vendet e numërimit të votave; qoftë të pajisjes elektronike të votimit e numërimit e më pas të miratojë edhe rregullat procedurale. Pra, së pari, miratojmë përdorimin dhe pastaj mënyrën e përdorimit. Kështu që edhe në këtë rast jemi në kushtet e një projekti pilot për shkak se ende votimi dhe numërimi elektronik nuk është i shtrirë në të gjithë vendin, megjithatë kemi një shtrirje relativisht të gjerë krahasuar me zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars të vitit 2022 dhe zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021. Kolegë, në parim, kemi diçka për projektvendimin? Jo. Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet në parim.

Projektvendimi është i shkurtër, ka tri pika. Përpara se të kalojmë aty, unë kam një, në fakt, nuk është propozim për ndryshim, por një rregullim që në titull “Përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve”, ndoshta është një lloj reminishence nga pajisja elektronike e identifikimit të zgjedhësve, pra kjo mendoj që nuk ka kuptim, është pajisje elektronike e votimit

***Zbardhi materialin audio
Alma KOLA***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

dhe numërimit, e kemi në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pra, vetëm fjalën “të zgjedhësve”, mendoj gjatë zbardhjes, nuk po e konsideroj si propozim për ndryshim. Fillojmë me radhë. Pika 1. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 procesi i votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve (PEVN) në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit.

***Zbardhi materialin audio
Alma KOLA***



Z. M. Çakaj: Të vendoset edhe standardi që kemi caktuar, ngarkimi. Në rastin konkret ngarkohet Komisioneri Shtetëror dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi, sepse bashkë e kemi të koordinuar punën. Është e disata herë që e përsërisim.

Znj. I. Nano: Pra, pas pikës 2 të shtohet pika 3 me këtë përmbajtje.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 3 bëhet pikë 4. Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe një herë dakordësinë tuaj, ju lutem.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Vendimi nr. 16

Data 13.04.2023
Ora 15:38

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimin elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimin (PEVN) në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y. Merhaj, D. Alimehmeti**
- **OJQ: KRIIK, ODIHR**

Znj. I. Nano: Kalojmë në projektvendimin e dytë, “Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimin elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimin (PEVN)”. Do t’i lutesha edhe një herë Sekretarit të Përgjithshëm, në mënyrë të përmbledhur të na paraqesë përmbajtjen e projektvendimit dhe shpjegimet përkatëse sipas relacionit.

Zbardhi materialin audio
Alma KOLA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Referuar nenit 20, pikat 1, të Kodit Zgjedhor Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Referuar nenit 20 dhe vendimit që miratoi Komisioni Rregullator “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit elektronik për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, si projekt pilot në tre bashki, kemi përgatitur projektvendimin e mësipërm për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes PEVN. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat procedurale për procesin e votimit të zgjedhësve në qendrat e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit PEVN, si dhe nxjerrjen e rezultatit nga Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve. Ky projektvendim përcakton procedurën e dorëzimit të pajisjes në Komisionin e Qendrës së Votimit përkatës, ku do të pilotohet votimi dhe numërimi elektronik nga ana e KQZ-së së bashku me kutitë shoqëruese, që mundësojnë votimin elektronik, procesverbalet dhe dokumentacionin tjetër që është përshtatur për këtë proces. Personeli teknik i ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN-së, në përfundim të votimit, kryen mbylljen e procesit në PEVN. PEVN-ja printon automatikisht raportin e mbylljes me rezultatin përkatës, i cili bie në kutinë shoqëruese që mundëson votimin elektronik. Në rastet kur transmetimi për arsye teknike që lidhen me PEVN-në ose modemi nuk ndodhet, procesi i nxjerrjes së rezultateve do të kryhet manualisht. Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet, pasi është dërguar informacioni dhe rezultati në KQZ, rezultati i votimit për çdo qendër votimi, ku do të zbatohet procesi pilot. Në zbatim të kompetencave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të përcaktuar

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

në nenin 19 të Kodit Zgjedhor, i propozojmë Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin e mësipërm.

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj! Unë doja të shtoja edhe diçka. Para pak ditësh Komisioni Rregullator ka miratuar një vendim, që ka ndryshuar specifikimet teknike të pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit, duke shtuar në këto specifikime edhe mundësimin e transmetimit të rezultati paraprak menjëherë pas mbylljes së procesit të votimit. Pikërisht në atë vendim kemi vlerësuar që procedurat e mëtejshme, lloji i të dhënave që transmetohen do të miratohen me një vendim të posaçëm të Komisionit Rregullator. Kështu që ky është pikërisht ai vendim që përcakton rregullat procedurale, por në brendinë e tij edhe gjithë informacionin që do të transmetohet për të shpallur rezultatin paraprak. Kolegë, votojmë në parim projektvendimin.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet në parim.

Fillojmë. Vendim “Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Zonja Vukaj pak më herët më tha që kishte diçka në titull për të korrigjuar apo për ta shtruar për votim.

Znj. H. Vukaj: Titulli mendoj se do të ishte më i sinkronizuar dhe do të gjente rrjedhë më të mirë drejtshkrimore apo edhe logjiko-formale në qoftë se do të përcaktonim që ky është një vendim që miraton rregullat, pra, për miratimin, ndaj propozoj të shtohen fjalët “për miratimin e rregullave” dhe në të njëjtën kohë pas fjalëve “votimit dhe numërimit elektronik”, të përdorim fjalët “me anë të” dhe jo fjalën “nëpërmjet”, siç është vendosur këtu.

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



Znj. I. Nano: Edhe një herë, propozimi i zonjës Vukaj është ndryshimi i titullit “Për miratimin e rregullave procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik me anë të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Kolegë, meqë kemi dy propozime, do ta kalojmë për votim.

Kush është dakord me titullin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Unë do të sugjeroja që kjo që sapo votuam, pra zëvendësimin e fjalës “nëpërmjet” me togfjalëshin “me anë të” të reflektohet edhe në tekstin e projektvendimit. Unë me aq sa të mundem, kur ta lexoj, do ta reflektoj tani. Fillojmë me shqyrtimin pikë për pikë. Pika 1. “Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 do të zbatohet projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave me anë të pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në të gjithë qendrat e votimit në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë”. Rregullime të vogla nëse është e mundur janë me karakter gramatikor. Kolegë, të mos i kalojmë, për shembull, “do të zbatohet”, “të zbatohet” për të dhënë mënyrë urdhërore rregullin. I reflektojmë gjatë zbardhjes? Po i përmendim nëse kemi aty këtu, për detajet teknike kemi drejtoreshën zonjën Alimehmeti për çdo pyetje që kemi. Atëherë jemi te pika 1.

Kush është dakord me përmbajtjen e pikës 1?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

2. “Në çdo qendër votimi të ketë të paktën 2 pajisje elektronike të votimit dhe numërimit”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 3. “Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV) për procedurat të cilat nuk janë të automatizuara, zbaton rregullat e përcaktuara në vendimin nr.11, datë 25.3.2021, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, të ndryshuar, ndërsa për procedurat e votimit dhe numërimin elektronik vepron në përputhje me aktet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të Komisionit Rregullator”. Po, zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Në fakt, procedura dhe rregullat e përcaktuara duhet të saktësojmë vendimin e Komisionit Rregullator. Nuk bëhet fjalë për vendimin nr. 11 të vitit 2021...

Znj. I. Nano: Jemi te pika 3, vendimi 11 është për KQV-në?

Z. M. Çakaj: Po, por nuk bëhet fjalë. Më fal. Është në pikën 4.

Znj. I. Nano: Për pikën 3 kemi diçka, kolegë? Po, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Për merak dhe në funksion të propozimit që nisi të bënte kolegu Çakaj, mendoj që administrata të riverifikojë edhe një herë vendimin nr.11, nëse i përshtatet pikës 3. Në rast të kundërt, të bëhet saktësimi gjatë zbardhjes.

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e pikës 3.

Kush është dakord?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 4. "KQZ-ja i dorëzon: a) Komisionit Zonal të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ-së), materialet zgjedhore që përdoren për procedurat të cilat nuk janë të automatizuara, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar; b) KQV-së, PEVN-të me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik, si dhe procesverbalet dhe dokumentacionin e punës të përshtatur për këtë proces". Zoti Çakaj, këtu e kishit ndërhyrjen?

Z. M. Çakaj: Ndërhyrja ishte këtu që të saktësohet vendimi i Komisionit Rregullator, pasi nuk bëhet fjalë për vendimin nr. 11 të datës 25.3.2021, por bëhet fjalë për vendimin nr. 5 të nëntorit të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, ku përcaktohen rregullat e organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së. Të saktësohet kjo në zbardhje të vendimit.

Znj. I. Nano: Do ta konsiderojmë saktësim, sepse rregullat janë të miratuara në vendim, që të jetë vendimi, datë, numër dhe titull.

Z. M. Çakaj: Referenca e saktë e vendimit të Komisionit Rregullator. Bëhet fjalë për vendimin nr. 5, datë 20.11.2020.

Znj. I. Nano: Votojmë pikën 4 me të dyja shkronjat "a" dhe "b".

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

Ndërkohë, sipas kërkesës së zotit Çakaj të bëhet saktësimi. Kemi pikën 5. “Vënia në funksionim e PEVN-së kryhet në qendrën e votimit, përpara hapjes së votimit, në prani të anëtarëve të KQV-së dhe të vëzhguesve të subjekteve, nga operatori teknik i PEVN-së, i caktuar nga KQZ-ja”. Kemi diçka për pikën 5? Jo. Kalojmë në votimin e pikës 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 6. “Operatori teknik i ngarkuar për përdorimin e PEVN-së, nëpërmjet kartave smart dhe kodeve përkatëse bën hapjen e PEVN-ve duke printuar dhe dorëzuar KQV-së raportin e hapjes së votimit, i cili tregon orën e hapjes, numrit e QV-së dhe të pajisjes si edhe zero pjesëmarrës në votim. Ky raport printohet në 8 kopje dhe firmoset nga anëtarët e KQV-së. Një kopje i dorëzohet sekretarit për ta ruajtur si material zgjedhor, një kopje e merr operatori teknik, kopjet e tjera u dorëzohen anëtarëve të KQV-së”. Lidhur me këtë pikë unë kam një saktësim dhe një propozim. Duke qenë që kemi nga dy pajisje në çdo qendër votimi, 2 PENV, atëherë kemi dy raporte të hapjes. Pra, thjesht për t’i kaluar në numrin shumë, “raportet e hapjes, të cilat”, pra të reflektohet në numrin shumë, ndërkohë në fjalinë e parafundit flasim për raportin e hapjes, që printohet në 8 kopje dhe firmoset nga anëtarët e KQV-së. Nëse do t’i referoheshim procesit manual të votimit, pra në qendrat e votimit ku nuk kemi PENV, procesverbali i hapjes firmoset dhe vulozet. Kështu që unë do të propozoja që ky raport, që nënkupton hapjen, pra është raporti i hapjes, printohet në 8 kopje, firmoset nga anëtarët e KQV-së dhe vulozet. Ky është propozimi im, kolegë. Kemi propozim tjetër për këtë pikë? Për të shtuar procesin e vulosjes, pra firmosjes dhe vulosjes, firmoset nga anëtarët e KQV-së dhe vulozet.

Kush është dakord me këtë propozim?

***Zbardhi materialin audio
Alma KOLA***



Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 7. “Në rastet kur votimi elektronik për arsye që lidhen me PEVN, nuk mund të fillojë, apo pasi ka filluar është ndërprerë dhe nuk mund të vijojë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos mbi vijimin e procedurës së votimit me fletë votimi.”. Kemi diçka për pikën 7? Po, zonja Vukaj.

Z. H. Vukaj: Kam pyetje për administratën dhe drejtoreshën përkatëse. A keni ekspozuar ju ndonjë akt tuajin të brendshëm apo manual teknik se cilat janë rastet konkrete kur PENV-të mund të dalin jashtë funksionit ose mund të konsiderohen të pamundura teknikisht për të realizuar procesin?

Znj. D. Alimehmeti: Përshëndetje! Në dy zgjedhjet e mëparshme, ku është pilotuar në Tiranë dhe në Vorë, nuk kemi pasur asnjë rast ku nuk është shpallur pamundësia për votimin elektronik. Gjithsesi, ne kemi në funksion rregullat operationale për funksionimin dhe zëvendësimin e pajisjeve, që do të thotë që për çdo qendër votimi ose për çdo bashki në këtë rast, përveç pajisjeve që janë të alokuara në qendrat e votimit, janë të ngritura edhe grupe që kanë pajisje *back up* rezervë. Në rastet kur një pajisje do të ketë probleme, problemet më të mundshme mund të jenë me printimin, këto kanë qenë detajet që kemi marrë si *feed back*, atëherë është zëvendësuar pajisja, është zëvendësuar printeri dhe është bërë i mundur vazhdimi i procesit, pra në eksperiencën tonë nuk kemi asnjë rast kur është ndërprerë votimi dhe është kaluar pastaj në pjesën manuale.

Znj. H. Vukaj: Do të thotë probabilisht ekziston një mundësi shumë e vogël që këto pajisje të mos funksionojnë. Por unë ende nuk mora përgjigje nëse ju i keni nxjerrë rastet me qëllim të evitohet abuzimin e personave që i përdorin apo janë

ngarkuar pranë QV-ve që t'i vënë në lëvizje në punë apo teknikisht t'i menaxhojnë. Cilat janë rastet kur këto mund të konsiderohen teknikisht jashtë funksionit, pra që mund të pengonin totalisht procesin? Ju a keni një pasqyrë teknike?

Znj. D. Alimehmeti: Përveç vandalizmave, gjë tjetër teknike nuk ka. Do të thotë, përveç rastit kur kjo pajisja dëmtohem me dashje, pjesë tjetër teknike, ose element teknik nuk ka që e bëjnë pajisjen të...

Z. M. Çakaj: Më falni, nuk ka apo nuk janë identifikuar deri tani, nuk kanë ndodhur?

Znj. D. Alimehmeti: Nuk ka ndodhur, nuk e kemi të identifikuar që të ketë.

Znj. H. Vukaj: Dhe ju nuk keni një panoramë sipas së cilës të na thoni se këto mund të jenë rastet eventuale ku pajisja del jashtë funksionit ose jashtë logjikës, apo parametrave elektronikë të punës së saj? Pra, a keni marrë ju nga firma një doracak se në çfarë rastesh teknike këto pajisje mund të pamundësojnë?

Znj. D. Alimehmeti: Nuk do të ishte ky, nuk do t'ia kërkonim këtë firmës, mendoj unë. Ideja është që këto duhet të jenë afër 100%-shit të sigurt që do të funksionojnë. Problemet janë të evidentuara, dhe ajo çfarë po mundohem të sqaroj, është që kryesisht problemet kanë pasur lidhje me printimin.

Znj. H. Vukaj: 100% -shi i sigurisë rezulton te kolaudimi i pranimit të pajisjes, pra, i certifikimit të pajisjes, por se cilat labirinte apo raste, të cilat mund t'i quajmë risk të prishjes së pajisje dhe trurit të pajisjes, (nuk jam teknike e fushës,

por po vërtitem të gjej terminologji në term atë të përgjithshëm), pra nuk keni deri tani dhe nuk keni as përvojë që prishen.

Znj. D. Alimehmeti: Jo, në eksperiencën tonë jo.

Znj. I. Nano: Atëherë, nëse nuk kemi propozime konkrete për pikën 7, unë do t'i ftoja kolegët të votojmë.

Znj. H. Vukaj: Këtu keni draftuar dhe propozoni “Në raste kur votimi elektronik për arsye teknike”, pra kur thua për arsye teknike, që lidhen me PEVN-në do të thotë që ti i di arsyet teknike. Pra, çfarë duhet të konsideroj unë arsye teknike sot?

Znj. D. Alimehmeti: Rastet kur nuk funksionon as pajisja as *bech up*-i që ne do të shkojmë. Do të thotë marrim rastet më ekstreme.

Znj. H. Vukaj: Vendoseni literalisht aty, për rastet teknike , këto që sapo thatë, që lidhen me PEVN-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Znj. I. Nano: Në fakt, edhe në aktet e më hershme, ne kemi miratuar mundësinë e zëvendësimit brenda dy orëve të pajisjes për çdo lloj problemi teknik që mund të shfaqet. Mosfunksionimi i pajisjes së re ose mosarritja në kohën e duhur mund të çojë në ndërprerjen e procesit të votimit elektronik dhe më tej të aktivizohet Komisioneri për të urdhëruar votimin manual. Personalisht mendoj që arsyet teknike mund të jenë nga më të ndryshmet që mund të çojnë në mosfunksionimin e një pajisjeje. Dhe ndoshta nuk do të ishte vendi në këtë akt, por, pa dyshim, në udhëzuesit e punës suaj duhen parashikuar të gjitha rastet dhe situatat. Pra, në këtë moment ne miratojmë rregullin, nëse nuk funksionojnë, të aktivizohet

votimi manual, pa i hyrë në detaje të gjitha shkaqeve që mund të çojnë në një defekt teknik, në një mosfunksionim teknik që në fillim, ose në ndërprerje. Megjithatë, unë do të doja të sillja në vëmendjen e administratës faktin që Kodi Zgjedhor detyron testimin parazgjedhor të pajisjeve, të të gjitha pajisjeve elektronike që përdoren në procesin e votimit, identifikimit. Kështu që, meqë është momenti, që sapo kanë ardhur pajisjet e reja, me siguri keni procesin e testimit parazgjedhor, për të mundësuar që pajisjet, që shkojnë në të gjitha qendrat e votimit në këto tri bashki, të jenë me parametrat e nevojshëm teknikë për të filluar funksionimin. Po, zonja Alimehmeti.

Znj. D. Alimehmeti: Është parashikuar testimi paraprak i të tëra pajisjeve duke implementuar dhe softuerin e ri dhe përmirësimet që janë bërë për përdorimin e këtyre pajisjeve. Do të jetë 3% e pajisjeve që do të përdoren sipas rregullave të Kodit Zgjedhor, dhe është në proces planifikimi dhe përmbylljeje, dhe deri në fillim të majit ky proces do të përfundojë.

Znj. H. Vukaj: Gjithsesi personalisht po e konsideroj që të mbetemi me këtë draftim të mbetemi në kushtet e pikës normuese parim dhe po e lë në përgjegjësinë tuaj këtë pjesën që të realizoni hapin 1, hapin 2 dhe të gjitha mjetet e sigurisë dhe garancisë që kjo gjë respektivisht të mos ndodhë.

Znj. D. Alimehmeti: Dakord.

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e pikës 7, kolegë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 8. Kryetari i KQZV-së kryen procesin e aktivizimit për votim të dy PEVN-ve në çdo QV me anë të butonit - po zëvendësoj fjalën “nëpërmjet” me “me anë të”- të tipit pulsant nga një për secilën pajisje. Kryetari i KQV-së nëpërmjet butonit të nipit pulsant aktivizon në mënyrë manuale PEVN-në për votim në kohën kur votuesi pasi ka kryer me sukses procesin e identifikimit në PEI, shkon te PEVN- për të votuar.” Kolegë, a keni ndonjë gjë lidhur me pikën 8?

Z. D. Çaka: Meqenëse ky akt është vazhdues edhe i akteve të mëparshme, që Komisioni Rregullator ka miratuar, referuar dhe atij për kriteret që duhet të plotësojnë pajisjet e votimit, të numërimit elektronik, ne, në atë akt kemi përcaktuar që në Komisionin e Qendrës së Votimit ky proces kryhet nga një nga anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit. Kështu që do të propozoja të mos e përcaktonim ne në këtë akt se kush do të ishte ai anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit, pra me funksion përkatës kryetari, por të jetë një nga anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit që do ta luajë këtë rol. Dhe në momentin e ndarjes së detyrave, që bëhet në Komisionin e Qendrës së Votimit, para fillimit të procesit të votimit, të jetë Komisioni i Qendrës së Votimit, që në ndarjen e detyrave përkatëse për çdo anëtar, të caktojë dhe kush do ta mbulojë këtë detyrë gjatë ditës së votimit. Faleminderit!

Znj. I. Nano: E përkthyer në propozim?

Z. D. Çaka: Propozimi është që një nga anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit kryen procesin e aktivizimit për votimin të dy PEVN-ve në çdo QV, me anë të butonit të tipit pulsant nga një për secilën pajisje, dhe njëkohësisht anëtari i KQV-së nëpërmjet butonit aktivizon në mënyrë manuale.

Znj. I. Nano: Pra, gjithmonë i ngarkuar nga KQV-ja.

Z. D. Çaka: Po, i ngarkuar nga KQV-ja, pra të jetë KQV-ja që të përcaktojë një nga anëtarët që luan këtë rol.

Z. I. Nano: Atëherë, kolegë për pikën 8 kemi këtë propozim që fjala “kryetari i KQV-së” të zëvendësohet me “një anëtar i ngarkuar nga KQV-ja” dhe të reflektohet në dy fjalitë, në fjalinë e parë dhe në fjalinë e dytë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kalojmë në pikën 9. “Zgjedhësi që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit elektronik, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose të një zgjedhësi tjetër që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë”. Besoj se nuk kemi ndonjë gjë për pikën 9. Kalojmë në votimin e pikës 9.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 10: “Në përfundim të procesit të votimit, pasi KQV-ja ka marrë vendimin për mbylljen e votimit, i kërkohet personit teknik, operatorit teknik -do të thosha operatorit teknik- të kryejë procesin e mbylljes së votimit në pajisjet PEVN, - në pajisjet sikundër thamë, po e lexoj në numrin shumës- , për pajisjet PEVN, si edhe printimin e raporteve të mbylljes”. Po bëj disa korrigjime të vogla duke i lexuar.

“Raportet e mbylljes së votimit përmbajnë të dhëna për: QV-në, numrin e zgjedhësve që kanë votuar dhe printohen në 8 kopje, dhe firmosen nga anëtarët e KQV-së”. Ky është drafti që ka ardhur, unë do të bëj një propozim më tej. Pas raporteve të mbylljes së votimit, printohen edhe raportet e rezultateve të PEVN-ve, të cilët bien në kutitë përkatëse shoqëruese të pajisjes. Ndjesë se po lexoj nga propozimi i ardhur nga drafti. “Operatori mund të printojë raportin e rezultatit të PEVN-së sipas kërkesave të subjekteve ose vëzhguesve”. Në fakt, zoti Çakaj, më tha diçka pak më herët, por, gjithsesi, unë kam disa propozime. Së pari, të reflektojmë numrin shumë, sepse thamë janë dy pajisje dhe janë dy raporte dhe “person teknik” në “operator teknik”.

Z. M. Çakaj: Dhe raporti i rezultatit, referuar standardit...

Znj. I. Nano: Të vulosen, siç thamë, pra, te fjalia e fundit: “Operatori mund të printojë raportin e rezultatit të PEVN-së”...

Z. M. Çakaj: Po edhe e parafundit.

Znj. I. Nano: Dhe te: “firmosen nga anëtarët e KQV-së dhe vulosen”, i njëjti standard që e morëm dhe me raportin e fillimit të çeljes së votimit, dhe te fjalia e fundit: “operatori mund të printojë raportin e rezultatit të PEVN-ve, sipas kërkesave të subjekteve zgjedhore. Këto raporte firmosen nga anëtarë e KQV-së dhe vulosen.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe vëzhguesve, po.

Z. M. Çakaj: Atëherë, përveç propozimeve që bëtë, ju, zonja kryetare, unë propozoj që të ndahen edhe si terminologji. Pra, kemi raport hapjeje të PEVN-së dhe raport mbylljeje të PEVN-së, me të dhënat që ju keni përcaktuar në akt.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

Ndërsa ajo që ju keni cilësuar, si raporti i rezultatit ,duke qenë se në aktet të tjera, por referuar dhe Kodit Zgjedhor konsiderohet si procesverbali i rezultatit, i propozoj dhe kolegëve që ta miratojmë, ta ndryshojmë fjalën “raport” me fjalën “procesverbal i rezultatit”. Dhe kjo reflektohet edhe në fjalinë e parafundit dhe në fjalinë e fundit.

Znj. I. Nano: Në fakt, meqë jemi duke e diskutuar unë do të kërkoja edhe asistencën e sekretarit të Përgjithshëm. Flasim për procesverbal të rezultatit. Në fakt, KQV-ja në procedurat manuale, nuk nxjerr rezultat, e nxjerr KZAZ-ja, po themi në ato manuale, pra, “procesverbali i rezultatit paraprak” mbase duhet ta quajmë.

Z.M. Çakaj: Dakord, por kur unë citova “procesverbali i rezultatit”, iu referova aktit që kemi miratuar ne në vitin 2020, në mos gaboj, për implementimin e teknologjisë, votim, numrin elektronik ku kemi identifikuar edhe specifikimet elektronike dhe SEMVR-në dhe PEVN-në dhe proceset që kemi renditur aty. Aty është e specifikuar: “procesverbali i rezultatit”. Dakord, mund të shtojmë “rezultati paraprak”, duke qenë se tagrin për shpalljen e rezultateve e ka KZAZ-ja.

Znj. I. Nano: Nga përvoja e dy viteve, ajo çka printohet jashtë, pra ai raport që bie në kuti që është hera e parë që aplikohet, ka ndonjë emërtim lart? Ai kuponi, po e quajmë tani, është një raport.

Znj. D. Alimehmeti: Raport përmbledhës ka qenë në dy vitet e mëparshme dhe ka të dhënat e QV-së, të PEVN-së, identifikuese, dhe të tëra të dhënat që përfshihen në fletën e votimit.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



Znj. I. Nano: Zoti Sekretar i Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaj: Raporti paraprak dërgohet në KQZ, dhe pastaj publikohet, nuk shpërndalet.

Z. M. Çakaj: Rezultati paraprak. Ne po flasim për tjetër gjë, ne po themi raporti që printohet kur mbyllet procesi. Pra e gjeneron automatikisht pajisja. Siç është kur aktivizohet pajisja, printon raportin e hapjes, kur mbyllet pajisja automatikisht printon raportin e mbylljes. Ndërkohë krahas këtyre dy raporteve printon edhe një dokument, i cili quhet procesverbali i rezultatit dhe ky bie në kuti. Krahas kësaj, edhe për transparencë të të gjitha palëve, këtë procesverbal të rezultatit paraprak, për të qenë korrekt dhe me terminologjinë dhe parashikimet e Kodit Zgjedhor, të gjitha, së pari duhet të firmoset, sipas propozimeve të zonjës Nano, duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët e KQV-së dhe të vuloset dhe së dyti, çdo subjekt, i cili dëshiron të pajiset me një kopje, mund të pajiset.

Z. Y. Merkaj: Për mua jo.

Z. I. Nano: Po, do të vendosim tani mbi këtë propozim.

Z. M. Çakaj: Po e vendosim ne këtë gjë.

Z. Y. Merkaj: Dakord, por më pyetët mua dhe për mua,

Znj. I. Nano: Unë ju pyeta për tjetër gjë, për terminologjinë raport-procesverbal. Si mendoni se është më e saktë? Si është bërë deri tani? Drejtoresha thotë që ka qenë raport përmbledhës.

Znj. D. Alimehmeti: Nga informacioni që unë kam ka qenë raport përmbledhës. Procesverbal më duket ka qenë anasjelltas me këtë, ka qenë procesverbali i hapjes dhe i mbylljes dhe raporti përfundimtar, në dijeninë time.

Z. I. Nano: Atëherë, unë do të propozoja diçka që të mos ngeceshim. Të përpiqemi të bëjmë harmonizimin pas mbledhjes, me aktet e tjera, për këto tri dokumente: raport hapjeje, raport mbylljeje, raport rezultati, ose procesverbal hapjeje, vetëm për emërtimin.

Z. M. Çakaj: Të biem dakord në parim që do të printohen tri dokumente, se për dy jemi dakord që konsiderohen raporte hapjeje dhe mbyllje ndërsa për të tretin ta harmonizojmë me aktet e mëparshme të miratuara nga ne.

Znj. I. Nano: Ndërkohë, propozimi im konkret është për të shtuar në fjalinë: “Raportet e mbylljes së votimit përmbajnë të dhëna për QV-në, numrin e zgjedhësve, që kanë votuar dhe printohen në 8 kopje, firmosen nga anëtarët e KQV-së dhe vulosen”, pra vulosja e tyre. Çfarë del nga kutia, nga pajisja duhet vulosur, është material zgjedhor dhe është një raport apo procesverbal më tej. Të fjalua e fundit dua ta riformuloj: “Me kërkesë të subjekteve ose vëzhguesve, dhe me miratim të KQV-së, operatori mund të printojë raportin e rezultatit ose procesverbalin e rezultatit, -siç do ta quajmë- raportet të cilat firmosen nga KQV-ja dhe vulosen. Sepse mund të kërkojnë shumë veta, por mendoj se është KQV-ja që t’i thotë printoje ose jo. Atëherë, aty mund të jenë në sallë pafund njerëz dhe operatori nuk e di nëse është vëzhgues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, duhet të jenë të akredituar patjetër. Operatori nuk bën asgjë automatikisht, me kërkesë të të tjerëve, do të duhet që të marrë një miratim paraprak nga KQV-ja. Mund t’i kërkojnë 20 veta, dhe KQV-ja t’i thotë: printoji 20. Pra, është një

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

miratim formal e të themi, sepse është KQV-ja që identifikon përfaqësuesit e subjekteve dhe vëzhguesit e çdo lloj organizate.

Z. M. Çakaj: Dakord, por çfarë ndodh nëse KQV-ja nuk e miraton këtë gjë? Çfarë ndodh? Nuk do të pajisen. Ndërkohë që, norma të cilën ne duhet ta miratojmë, së pari udhëhiqet nga parimi i transparencës.

Znj. M. Vukaj: E drejta për informim.

Z. M. Çakaj: Sigurisht e drejta për informim. Dhe nga ana tjetër subjektet që kërkojnë pajisjen me rezultatin, pra bëhet fjalë për një proces, së pari, paraprak, së dyti, do të duhet t'u vihet në dijeni për sa kohë janë si subjekte të akredituara nga KQZ-ja, ashtu edhe vëzhgues të akredituar. Nuk shoh ndonjë problem këtu, përveç harxhimit të letrës. Besoj kur të mbarojë letra të marrin vendim u harxhua letra.

Znj. H. Vukaj: Në aktet tona pararendëse nuk e kemi kushtëzuar me një diskrecion të tillë dedikuar Komisionit të Qendrës së Votimit.

Znj. I. Nano: Se në aktet e mëhershme ne nuk kemi pasur situatën e printimit dhe dhënies.

Znj. H. Vukaj: Kemi pasur, e kemi për analogji momentin kur kërkojnë kopje të dokumentacionit.

Znj. I. Nano: Në KZAZ, për shembull, kur kërkojnë kopje të dokumentacionit. Pra, kjo gjë në çdo rast duhet dokumentuar, qoftë edhe me një procesverbal, që u

dhanë kaq kopje, të dimë sa printoi dhe pse printoi 7, 8 , 15 kopje. Pra, thjesht unë e dua të dokumentuar.

Znj. H. Vukaj: Dokumentimi është një gjë tjetër dhe vendimmarrja për të dhënë ty të drejtën për t'u informuar për këtë rezultat ose për çfarë gjeneroi pajisja ...

Znj. I. Nano: Të lutem, zonja Vukaj, që ta mbaroj argumentin tim, pse e bëj këtë propozim. E para, një herë këtu nuk është çështje e drejtës për informim dhe nuk funksionon ligji për të drejtën e informimit. Ky është një rregull që zbatohet në një projekt pilot, sepse përndryshe Kodi Zgjedhor nuk të lejon nxjerrje dhe transmetim të rezultatit paraprak. Pra, është një rast përjashtimor. Ne vetë e kemi miratuar në kuadër të transparencës, që KQZ –ja në përgjithësi, duke marrë rezultatet e gjithë PEVN-ve dhe gjithë QV-ve në këto 3 bashki, të nxjerrë rezultatin paraprak për bashkinë konkrete, për zonën zgjedhore konkrete jo për QV-të me radhë apo për çdo pajisje me radhë. Nuk është çështje e të drejtës për informim dhe nuk kanë detyrimin anëtarët e KQV-së për të informuar, po themi, publikun. Në këtë rast, pa dyshim që subjektet zgjedhore kanë përfaqësuesit e tyre në QV, organizata të ndryshme kanë vëzhguesit e tyre në QV, unë them thjesht ta rregullojmë, të gjejmë një mekanizëm rregullues për këtë proces. Pra, të dimë nëse... Nuk e di operatori, e di KQV-ja. Ja unë këtu pyes sekretarin e Përgjithshëm për përfaqësuesit. Pra, operatori nuk mund të dijë...

Z. M. Çakaj: Jo, jo e di KQV-ja, por KQV-ja do të zbatojë rregullin që do të normojmë ne, nuk diskutohet.

Znj. I. Nano: Operatori nuk e di them, kush është përfaqësues...

Z. M. Çakaj: Patjetër, patjetër, po ne do ta miratojmë rregullin si për operatorin, ashtu edhe për KQV-në dhe nëse e kufizojmë këtë gjë, atëherë automatikisht...

Znj. I. Nano: Unë them ta rregullojmë.

Z. M. Çakaj: Dakord, e rregullojmë. Atëherë, nëse ju vjen për ta rregulluar, unë propozoj që operatori mund të printojë raportin e rezultatit të PEVN-së, sipas kërkesave të subjekteve zgjedhore, përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore ose vëzhguesve të akredituar dhe ua vë në dispozicion atyre dhe këtu e kufizon numrin e raporteve që do të printohen, se një qendër votimi nuk mund mbajë më shumë sesa të paktën 3 subjekte, të cilat do të kandidojnë në 61 bashki. Tashmë i kemi identifikuar që 3 janë subjektet që do të kandidojnë në 61 bashki, që kanë paraqitur kandidatë. Të paktën, këta të 3 e kanë edhe më të madh interesin për të marrë pjesë në zgjedhje, sigurisht, por edhe për t'u njohur me rezultatin, të paktën këtyre, por edhe çdo vëzhguesi tjetër.

Znj. I. Nano: Çdo vëzhguesi tjetër edhe çdo përfaqësuesi. Ne këtu nuk kufizojmë se sa përfaqësuesve mund t'u jepet, pa dyshim mund të jenë 3, mund të jenë 10, 15.

Z. M. Çakaj: Zonja Nano, merakun im është në rast se ne do të shtojmë edhe një hallkë. Unë vlerësoj se mund të shtojmë...

Znj. I. Nano: Të dokumentojmë procesin...

Z. M. Çakaj: Jo, dakord e dokumentojmë procesin, po nëse e shtojmë një hallkë vendimmarrjeje te KQV-ja, atëherë çfarë ndodh nëse KQV-ja nuk merr vendim, nuk pranon ta vërë në dispozicion këtë raport.

Znj. I. Nano: KQV-ja mund të çmendet në çdo lloj procesi, që te butoni që pulson, Meraku im në këtë propozim është që të mos jetë në kontakt të drejtpërdrejtë operatori me vëzhguesin, operatori me përfaqësuesin e subjektit, ky është meraku im.

Z. M. Çakaj: Po pse çfarë problemi ka?

Znj. I. Nano: Operatori është vetëm, pra, nuk ka fuqi vendimmarrëse në këtë rast.

Z. M. Çakaj: Jo, jo po nuk ka çfarë vendimi do të marrë. Bëhet fjalë për një dokument për të cilin tashmë ka mbaruar procesi. Shanset që ai të ndërhyjë i ka zero.

Znj. I. Nano: Jo, nuk është çështja të ndërhyrja, nuk themi që do të ndërhyjë, se të ndërhyrja e thamë: firmosjen, vulosjen. Pra, që të jetë dokument zyrtar.

Z. M. Çakaj: Po atëherë në kuadër të transparencës, le t'ua vëri palëve të cilat kanë interes të ligjshëm dhe unë sapo të identifikova, të paktën, 2 palë që kanë interes të ligjshëm. Një, subjektet zgjedhore, që kandidojnë në 61 bashki dhe, së dyti, vëzhguesit e akredituar pranë KQZ-së. Këta kanë provën, se kanë interes të ligjshëm, provojnë se kanë interes të ligjshëm dhe duan të njihen me rezultatin. Tashmë rezultati është paraprak, është i certifikuar nga PEVN-ja, është i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KQV –së, është i vulosur nga KQV-ja dhe nuk shoh asnjë problem pse të njihen këta. E kanë zero mundësinë për të ndërhyrë në këtë dokument, thjesht, do të njihen në kuadër të transparencës. Nuk shoh ndonjë problem, e kam sinqerisht.

Znj. I. Nano: A ka mundësi të dokumentohet ky proces?

Z. M. Çakaj: Le ta shënojnë në librin e protokollit...

Znj. I. Nano: Po, pra këto janë 2 alternativat që unë solla. Pra, në çdo rast duhet pasqyruar diku, që u printuan dhe ju dhanë X-t, Y-t, Z-s. Prandaj ishin 2 momente, mënyra e dokumentimit ose do të jetë me vendim KQV-je, ose do të jetë me shënim në procesverbal. Po procesverbali i mbledhjeve kur mbyllet?

Znj. H. Vukaj: Mënyra e dokumentimit është aspekt procedural formal ...

Znj. I. Nano: Unë dua gjurmën, këtë jam duke thënë. A ka mundësi mbasi të jetë mbyllur votimi të mbahet... Libri i protokollit, vazhdon, mbyllet? Është?

Z. M. Çakaj: Vazhdon deri në momentin që mbyllet.

Znj. I. Nano: Atëherë e shënojmë në...

Znj. H. Vukaj: Gjurma është një gjë tjetër.

Z. M. Çakaj: Vazhdon, sepse pasqyrohen edhe këto procesverbale.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj, unë e di që është gjë tjetër prandaj bëra 2 propozime: o njërin, o tjetrin, cili qëndron më mirë. Prandaj janë 2, se janë të ndryshme. Këtë po them ose me një vendimmarrje të KQV-së, ose me një dokumentim të faktit, po jo në ajër.

Znj. H. Vukaj: E kuptoj edhe në vijim të atij diskutimit të propozimit të parë, po japim argumentet shtesë, që ky diskrecion bën që të kalohet në diskrecion subjektiv, për më tepër, në këto zgjedhje operatori është i ngarkuar, siç ju e keni thënë dhe e kemi pranuar, që ka atë kontratën dhe mban përgjegjësi përballë asaj kontrate që ka firmosur këtu në KQZ. Pra, merr të gjitha përgjegjësitë përpara ligjit për çfarëdolloj ndërhyrjeje apo për çfarëdolloj “makinacioni”, që mund të përdorë ose t’i...

Znj. I. Nano: Më duket se e kapërcyem këtë diskutim, jemi të dokumentimi. Në këtë moment vijon të jetë i hapur libri i protokollit?

Znj. H. Vukaj: Po unë a kam të drejtë ta mbaroj të gjithë frazën që nisa?

Znj. I. Nano: Unë e mbarova propozimin pastaj të dokumentohet në librin e protokollit, kaq.

Znj. H. Vukaj: Po cilin nga propozimet ndani tani, vetëm të dokumentohet?

Znj. I. Nano: Ja, pra unë prandaj se po pyesja të dokumentohet.

Z. M. Çakaj: Edhe në librin e mbledhjeve të protokollit të KQV-së.

Znj. H. Vukaj: Për më tepër që në këto zgjedhje e dimë shumë mirë se si është baraspesha e subjekteve zgjedhore në tryezat e KQV-ve. Komisionet e qendrave të votimit nuk janë në baraspeshën e duhur.

Znj. I. Nano: Jo nuk na duhet fare kjo gjë. Unë do të kërkoja 5 minuta pushim të konsultohemi me Kodin Zgjedhor para se të vijojmë.

Znj. H. Vukaj: Përpara se të kalojmë ta kemi të kompletuar. Ju lutem, kam edhe një propozim këtu te fjalia, në renditje është e katërta. Fillon pas presjes së PEVN-së, i cili bie “brenda kutisë shoqëruese të pajisjes”. Pra, të shtohet fjala “brenda kutisë shoqëruese të pajisjes”.

Znj. I. Nano: Atëherë ndërpresim 10 minuta mbledhjen, ju lutem, dhe rifillojmë më vonë.

Rifillon mbledhja

ora 16:47

Znj. I. Nano: Jeni gati për të rifilluar? Dakord. Rifillojmë mbledhjen pas disa konsultimeve që patëm me Kodin Zgjedhor dhe me administratën për disa aspekte teknike. Kemi mbetur te pika 10, për të cilën, edhe me konsesusin e kolegëve, propozoj një riformulim të përbashkët. “Në përfundim të procesit të votimit, pasi KQV-ja ka marrë vendimin për mbylljen e votimit, i kërkohet operatorit teknik të kryejë mbylljen e procesit të votimit në pajisjet PEVN, si edhe printimin e raporteve të mbylljes. Raportet e mbylljes së votimit përmbajnë të dhëna për QV-në, numrin e zgjedhësve që kanë votuar, printohen në 8 kopje dhe firmosen nga anëtarët e KQV-së dhe vulosen. Këto raporte u dorëzohen: sekretarit të KQV-së, anëtarëve të KQV-së dhe operatorit teknik. Pas mbylljes, pas printimit të raporteve të mbylljes së votimit printohet edhe procesverbali i rezultatit të PEVN-së, i cili bie brenda në kutinë shoqëruese të pajisjeve. Operatori printon 8 kopje të procesverbalit të rezultateve të PEVN-ve, të cilat firmosen nga anëtarët e KQV-së dhe vulosen, dhe u dorëzohen: sekretarit të KQV-së, operatorit dhe anëtarëve të KQV-së. Operatori mund të printojë raportet e rezultateve të PEVN-së sipas kërkesave të subjekteve ose vëzhguesve të paraqitura në KQV. Këto raporte



duhen të jenë të firmosura dhe vulosura.” Kolegë, i përmbush ky propozim të gjithë diskutimet që bëme paraprakisht? Atëherë po e kalojmë në votimin e pikës 11. Të pikës 10, më falni!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka.

Me 5 vota pro miratohet.

Kalojmë në pikën 11. “Vetëm pasi është mbyllur procesi në PEVN dhe është printuar raporti sipas pikës 10 të këtij vendimi, personeli teknik i ngarkuar në KQZ-ja për përdorimin e PEVN-së vendos në një nga portat USB të PEVN –së, modem USB me kartë SIM, i cili mundëson transmetimin e rezultatit paraprak të PEVN –së në SEMVR. Ky modem konfigurohet vetëm nga stafi i KQZ-së.” Këtu ka vetëm 2 gjëra që janë saktësim dhe rrjedhojë e atyre çfarë thamë më parë. Kur flasim është printuar raporti, bëjmë fjalë për procesverbalin e rezultatit, sipas pikës 10, nga stafi përgjegjës i KQZ-së. Këto janë 2 propozimet e mia për pikën 11. Stafi përgjegjës dhe procesverbali për ta reflektuar atë që miratua më sipër, procesverbali i rezultatit paraprak. Kalojmë në votimin e pikës 11, me këto të dy: njëri korrigjim dhe tjetri ndryshim. Po, zoti sekretar i Pwrgjithshëm, kishit diçka që mund të na ketë shpëtuar gjatë diskutimit?

Z. Y. Merkaj: Jo.

Znj. I. Nano: Votojmë pikën 11.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka.

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 12. “Të dhënat që do të transmetohen nëpërmjet modemit USB janë: Kodi unik i identifikimit të PEVN-së, numri total i votave elektronike, numri i votave

elektronike të vlefshme, numri i votave elektronike në të cilat nuk është votuar për asnjë nga kandidatët, subjektet zgjedhore në fletën e votimit, numri i votave elektronike për çdo kandidat subjekt zgjedhor.” Edhe këtu gramatikisht duhet nëpërmjet “me anë të” që thamë edhe gramatikisht në rasën emërore këto kodi, numri etj, me radhë. Kemi diçka për pikën 12? Jo. Kalojmë në votimin e pikës 12.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 13. “Të dhënat transmetohen në një format të sigurt dhe të pandryshueshëm nëpërmjet certifikatave dhe çelësave të inkreptuar nga PEVN-ja drejt SEMVR-së. Informacioni që do të transmetohet nga PEVN-ja drejt SEMVR-së të KQZ-së aksesohet vetëm nga stafi përgjegjës i KQZ-së.” Personalisht këtu kam vetëm të hiqet kjo KQZ-ja e parë drejt SEMVR të KQZ-së se del 2 herë KQZ-ja, dhe SEMVR-ja nënkuptohet që është në KQZ. Kolegë, votojmë pikën 13.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka.

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 14. “Në rastet kur transmetimi, për arsye teknike që lidhen me PEVN ose me modemin, nuk ndodh, procesi i nxjerrjes së rezultateve paraprake do të kryhet manualisht sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara me anë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.” Kemi diçka për pikën 14? Jo, Kalojmë në votimin e pikës së 14.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



Me 5 vota pro miratohet.

Pika 15. “Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet pasi është dërguar në KQZ rezultati i votimit për çdo qendër votimi ku zbatohet projekti pilot.” Personalisht mendoj që duhet shtuar për saktësi “rezultati paraprak nxirret dhe publikohet nga KQZ-ja pasi është dërguar në SEMVR rezultati i votimit për çdo qendër votimi ku zbatohet projekti pilot. Rezultati i votimit për çdo PEVN, se çdo PEVN e transmeton në mënyrë të pavarura nga tjetra.” Pra, këto janë saktësimet në pikën 15.

Kolegë kush është dakord? Nëse ka diçka, mund të na ndërprisni në çdo moment, administrata. Çdo PEVN e dërgon në mënyrë të pavarur këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Rezultati paraprak nxirret nga KQZ-ja pasi është dërguar këtu, pasi është dërguar çdo informacion nga çdo PEVN. PEVN-ja e dërgon tek e tek. Po teknike është, çfarë të bëjmë tani. Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet nga KQZ-ja. Çfarë nënkuptoni me rezultat paraprak, për çdo qendër apo për gjithë zonën zgjedhore?

(Diskutime pa mikrofon)

Informacioni çohet tek e tek. Rezultati paraprak mund të jetë rezultat për qendër votimi, mund të jetë edhe për të gjithë zonën zgjedhore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, nuk ka tha njëri për PEVN-në. Më dëgjoni, ju lutem, jo po je lodhur, unë ju kuptoj. Ja le ta lexojmë edhe një herë. Pra, ajo çka mbetet të saktësojmë është: rezultat paraprak për QVN-në edhe zonën zgjedhore, se do t’i nxjerrë të dyja KQZ-ja paraprake. “Rezultati paraprak për çdo QV dhe për çdo zonë zgjedhore nxirret dhe publikohet nga KQZ-ja pasi është dërguar në SMEVR rezultati i votimit për çdo PEVN të çdo qendre votimi, ku zbatohet projekti pilot.” E votojmë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



Kundër: S'ka.

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 16. "Procesi i nxjerrjes së rezultateve për çdo QV realizohet nga KZAZ-ja në ambientin e VNV-së. Jemi te pika 16. Këtu duhet theksuar që bëhet fjalë për rezultatin përfundimtar. Pra, projekti i nxjerrjes së rezultatit përfundimtar për çdo QV, realizohet nga KZAZ –ja në ambientin e VNV –së.

Kush është dakord me këtë propozim të pikës 16?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka.

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 17. "Pas mbylljes së votimit, KQV-të dorëzojnë pranë VNV-së pajisjet PEVN së bashku me materiale të tjera zgjedhore." Edhe këtu është në KZAZ, sepse ai është organi, komisioni ku dorëzohen. Pra, pas mbylljes së votimit KQV-të dorëzojnë në KZAZ, pajisjet PEVN së bashku me materialet e tjera zgjedhore.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka.

Me 5 vota pro miratohet pika 17.

Pika 18. "Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë KZAZ-së të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja në prani të vëzhguesve kryen procesin e numërimit të votave në sistemin elektronik të menaxhimit të votimit dhe rezultateve SEMVR sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara me akt të Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve". Kemi diçka për pikën 18?

Z. M. Çakaj: Kisha unë një pyetje për drejtoreshën. Atëherë në ambientet e KZAZ-së do të jetë i instaluar një monitor, një pajisje. Ky monitori ka lidhje, pra duhet të ketë një lidhje *data transfer* me SEMVR-në, apo jo? Si realizohet ky proces teknikisht?

Znj. D. Alimehmeti: Idea është që do të ketë për çdo KZAZ pajisje laptop të cilët kanë të instaluar, kanë të lidhur programin, i cili bën kalkulimin automatik që në momentin e parë kur vendoset USB-ja për çdo QV. Pastaj ky mund të jetë i lidhur me një televizor, sepse ai bën thjesht kalimin e informacionit dhe nuk bën gjë tjetër, vetëm për transmetimin.

Z. M. Çakaj: Nga laptopi te monitori dhe të dhënat i merr nga SEMVR-ja.

Z. D. Alimehmeti: Po

Z. M. Çakaj: Qartë, dakord, faleminderit!

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e pikës 18, ju lutem?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 19. "SEMVR-ja do të kryejë përlllogaritjen e rezultatit dhe do të shfaqë në monitor dhe do të printojë në letër tabelat e rezultateve për çdo QV, si dhe tabelën përmbledhëse të rezultateve, sipas modeleve të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve."

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 20. "Tabelat e rezultateve si për QV-në dhe në nivel ZAZ-je firmosen nga anëtarët e KZAZ-së. Tabela përmbledhëse e rezultateve miratohet me vendim nga KZAZ-ja."

Znj. I. Nano: Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Pika 21. Në rastin kur proceduara e votimit është zhvilluar në njërin pjesë të ditës elektronikisht dhe në një pjesë tjetër të ditës manualisht, KZAZ aktivizon GNV-të të ndjekin procedurat standarde për hapjen e kutive të votimit numërimit, vlerësimit dhe nxjerrjes së rezultateve sipas udhëzimeve të KQZ-së, vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike. Kemi diçka me pikën 21? Kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Pika 22. Komisionieri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për informimin e zgjedhësve dhe të administratës zgjedhore në lidhje me përdorimin e PEPN-së

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Pika 23. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.04.2023*

Pika 24. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi. Edhe një herë dakordësinë Tuaj. Komisionieri dhe administrata ë ... Propozimi i zonjës Vukaj.

Për pikën 24 kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Edhe një herë dakordësinë Tuaj, ju lutem.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Mbasi kemi miratuar në parim dhe pikë për pikë projektvendimin, i cili ka pësuar jo pak ndryshime, për të cilat do të kërkoja vëmendje të shtuar nga ana e administratës dhe konsultim me anëtarët e Rregullatorit përpara zbardhjes, kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet

Vendimi nr. 17



*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 13.04.2023*

**Data 13.04.2023
Ora 17:02**

JASHTË RENDI I DITËS

PJESËMARRJA:

- **KQZ:**
 - **Komisioni Rregullator:**

| | |
|-----------------------|-----------------|
| Ilirjana NANO | Kryetare |
| Arens ÇELA | Anëtar |
| Dritan ÇAKA | Anëtar |
| Helga VUKAJ | Anëtare |
| Muharrem ÇAKAJ | Anëtar |
 - **Stafi i KQZ-së:** **Y. Merkaj, D. Alimehmeti**
- **OJQ:** **KRIIK, ODIHR**

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj ka kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës.

Znj. H. Vukaj: Normalisht do ta nisja diskutimin me atë kërkesë përvijuese timen, se çfarë është bërë në lidhje me shqetësimet e adresuara me institucionet e ndryshme, të cilat përmbajnë database-in me informacionin në lidhje me veprimtaritë e ndaluara, të cilat janë kryefjalë dhe rend i çdo mekanizmi viziv. Pra, në media nga mëngjesi deri në darkë, kemi vetëm veprimtari të ndaluara dhe për hir të informimit, unë kam kërkuar z. Sekretari i Përgjithshëm të pajisemi me informacion institucional nga institucione të ndryshme në lidhje me këtë pikë. Përpos kësaj, do të kaloj me pyetje pas temës që zgjedh të ketë vëmendje të veçantë për shkak se është shumë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 13.04.2023**

shqetësuese. Bëhet fjalë për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Në dijeninë time në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur listat dhe janë paraqitur ekstraktet 1, 2, të cilat rezultojnë të ishin në rregull me Kodin Zgjedhor dhe në përputhje me kushtëzimet apo kriteret që vendos Kodi Zgjedhor. Më pas kemi gjenerimin e ekstraktit 3, devijues, të cilat dukshëm bien ndesh jo vetëm me Kodin Zgjedhor, por druaj se do të shkaktojnë kaosin më të madh historik që mund të ketë ndodhur ndonjëherë në zgjedhjet që ka zhvilluar ky vend. Bëhet fjalë për tjetërsimin e qendrës së votimit të pothuajse të 1.3 milionë zgjedhësve dhe kjo shifër ka dalë nga kryqëzimi i të dhënave dhe nga auditimi i tyre. Ose është e tmerrshme të thuash që kjo përben 35 % të të gjithë zgjedhësve dhe në të njëjtën kohë specifikisht po i adresohem vetëm një shembulli, bashkisë Kamëz, ku 64 % e zgjedhësve iu është ndryshuar qendra e votimit. Nuk ndodhemi as përballë kriterit 1 dhe kriterit 2 që përcakton Kodi Zgjedhor, por, siç e dini kriteri 1 është kur bashkohen qendrat e votimit ose... si pasojë eshkrirjes apo bashkimit të qendrave të votimit dhe kriteri 2, kur me kërkesë të qytetarit, shtetasit shqiptar me të drejtë vote. Pra, zgjedhësi në këtë rast, i adresohet gjendjes së tij civile për të ndryshuar qendrën e votimit për shkak se ka ndryshuar vendbanimin dhe vendqendrimin. Në momentin kur nuk përballemi as me njërin as me tjetrin, natyrshëm, më lind dyshimi i arsyeshëm që kriter tjetër ligjor nuk shoh të ketë përveçse ndonjë kriteri të shpikur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila nuk e di nëse është në dijeni të saj që kjo përben vepër penale dhe përballat në këtë rast Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me gjithë pasojat që do shkaktonte ditën e zgjedhjeve për zgjedhësit, të cilëve u mohohet ose u pamundësohet e drejta e votës vetëm për këtë rast. Marr shkas dhe nxitje nga ky fenomen, i cili ka prekur personalisht familjen time, ku 2 më të vjetërve të familjes, dy gjyshërve të familjes u zhvendoset qendra e votimit në një njësi administrative të paqenë ndonjë herë pa asnjë lloj justifikimi, pa asnjë lloj shpjegimi, dhe pa asnjë

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 13.04.2023*

kërkesë nga ana e tyre. Unë, nuk do të doja të mendoja kurrsesi që ky është skenar dhe pjesë e gjithë tentativës për t'i shërbyer listës përlllogaritëse apo lehtësimit të punës së patronazhistëve apo ndonjë skenari tjetër që çon drejt minimin të së drejtës së votës. Do të thosha që kjo ka cenuar rëndë parimin e sigurisë juridike, dhe i bëj thirrje Gjendjes Civile, mundësisht Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Ministrisë së Brendshme të korrigojnë këto aspekte të kësaj të drejte themelore të shtetasve shqiptarë dhe votuesve. Në të njëjtën kohë do të kërkoja nga Gjendja Civile dhe Ministria e Brendshme, pra, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të di numrin e shtetasve shqiptarë, pra me të drejtë vote, të cilët janë në prag të një dokumenti ID në prag skadence apo pavlefshmërie, për arsye se në çdo vit zgjedhor është ndjekur praktika e mundësisë apo shtyrjes së afatit për këtë kategori zgjedhësish, pra shtyrja e afatit për vlefshmërinë e ID-ve. Fillimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm dua që t'i adresohesh me një shkresë, që të kemi një informacion të plotë; sa është numri i këtyre zgjedhësve dhe cila është politika që do të ndjekë Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në këtë drejtim? Faleminderit!

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj faleminderit, zoti Sekretari i Përgjithshëm keni diçka për të thënë tani? Po!

Z. Y. Merkaç: Me sa di unë Komisioneri i ka dërguar një shkresë Drejtorisë së Gjendjes Civile për problematikat që shtroi anëtarja e Komisionit Rregullator, i kemi nisur një kërkesë Komisionierit dhe Ministrisë së Brendshme për shtyrjen e afatit të kartave të ID-ve që u ka skaduar afati ose janë në skadim të afatit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Datë 13.04.2023**

Znj. I. Nano: Sapo ta kemi një informacion të tillë, qoftë në mbledhjen publike të radhës, qoftë në email-et tona zyrtare të na i vini në dispozicion, ju lutem.

Z. Y. Merkaç: Patjetër!

Znj. H. Vukaj: Pra do ta shteronte kjo kërkesë e Komisionierit, faktin që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mund të korrigjonte këto lista që tashmë konsiderohen përfundimtare, të pranojë këtë shkaktim të kësaj vorbulle apo cenimit të së drejtës për të votuar të shumë zgjedhësve? Të 1.3 milionë zgjedhësve? Ssepse kjo bie totalisht ndesh me atë se çfare kemi votuar deri tani. Bie ndesh me Kushtetuten dhe une nuk e di çfare për ligjje dhe argumenti nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në këto rrethana që ka shkaktuar. Kaosi në ditën e zgjedhjeve do t'i mbetet asaj faturë Dhe ndërkohë unë shosh zgjidhje vetëm tek ndonjë organ ligjzbatues i përgjegjshëm, që të gjitha rastet që do të denoncohen kryesisht në këtë periudhë, ta shikojnë nën optikën e një krimi zgjedhor. Gjithashtu gjej rastin t'u bëj thirrje vëzhguesve të OSBE/ODIHR-it, të marrin në shqyrtim këtë tematikë, sepse është vërtet shumë shqetësuese që 1.3 milionë zgjedhës, ditën e votimit të hallakaten dhe mos të kenë mundësinë t'u adresohen qendrave të votimit, atje ku kanë votuar në të gjitha herët, apo kanë shprehur të drejtën e tyre legjitime për të zgjedhur.

Znj. I. Nano: Faleminderit edhe një herë! Duke qënë që nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës apo jashtë rendit të ditës për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

